



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-30529/22 datë: 26.10.2022



Npi – 01/351 datë: 28.10.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 28.10.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 28.10.2022 (premtë) në ora 11:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë Zëvendës Kryesuesi i KPK-së z.Muhamed Mehmeti, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Arton Demiri, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveq anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Valmira Hoxha - praktikante.

Mbledhjen e hapi Zv.Kryesuesi z.Muhamed Mehmeti i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshmë për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 26.09.2022,
2. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së,
3. Diskutim për ofrimin e lehtësirave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për komunitetin pakicë,
4. Diskutim për mundësinë e ofrimit të shërbimeve falas të Mamografit për banorët e komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes,
5. Diskutim për mundësinë e furnizimit të familjeve në nevojë me lëndë djegëse, nga komuniteti pakicë,
6. Diskutim për Organizimin e vizitave të KPK-së në shkollat qe kanë nxënës të komunitetit Ashkali dhe Rom,
7. Te ndryshme.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

znj.Rrezartë Ramadani; Propozoj që pika e rendit të ditës me nr. 4 “Diskutim për mundësinë e ofrimit të shërbimeve falas të Mamografit për banorët e komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes” të hiqet nga rendi i ditës, unë nuk po e shoh të arsyeshme me qëndruar në rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës pa pikën 4 “Diskutim për mundësinë e ofrimit të shërbimeve falas të Mamografit për banorët e komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 26.09.2022

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 26.09.2022.**

Pika 2

Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete unanimisht vendosi që të kërkojë nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim që Informatën, sipas pikës 2 të rendit të ditës “Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së”, për anëtarët e Komitetit për Komunitete ta dërgojë me e-mail.**

Pika 3

Diskutim për ofrimin e lehtësirave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për komunitetin pakicë
zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi që pika e 3 rendit të ditës “Diskutim për ofrimin e lehtësirave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për komunitetin pakicë”, të shtyhet për mbledhjen e radhës të KPK-së, duke e kombinuar me pikat e planifikuara përmuajin Nëntor – 2022, sipas Planit të Punës.**

Pika 4

Diskutim për mundësinë e ofrimit të shërbimeve falas të Mamografit për banorët e komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes

***Komiteti për Komunitete, në fillim të mbledhjes me miratimin e rendit të ditës, unanimisht ka vendosur që pika e 4 “Diskutim për mundësinë e ofrimit të shërbimeve falas të Mamografit për banorët e komunitetit Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes”, të hiqet nga rendi i ditës.**

Pika 5

Diskutim për mundësinë e furnizimit të familjeve në nevojë me lëndë djegëse, nga komuniteti pakicë

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Përvendosje, kjo pikë e rendit të ditës është dashur të emërtohet si Informatë e jo diskutim.

z.Arton Demiri; Përvendosje, Unë bashkë me një bashkatdhatarë nga diaspora, kemi arrit me shpërndë tri familjeve të komunitetit pakicë me nga një shporet me dru për ngrohje dhe po ashtu me nga një thes miell.

znj.Rrezartë Ramadani; Të përgëzoj Arton për këto, ç'ka ke arrit me bërë sa do pak për komunitetin.

z.Arton Demiri; Ata i kanë listat e nevojtarëve, fjalën e kamë për QPS-në, dhe nga lista e nevojtarëve ata asnjë nuk e lanë pa i dhënë ndihma, unë mendoj se nuk ka pasur nevojë për një diskutim të tillë, sepse nuk ka as diskriminime as shkelje, mirëpo kur po i dëgjojë, si pika të rendit të ditës po më duken jo të mira.

znj.Shkurte Mustafa; Kur po shqyrtohet kjo pikë, e fiton përshtypjen se vetëm ky komunitet nuk ka lëndë djegëse, e që nuk është e vërtetë, sepse për lëndë djegëse kanë nevojë shumë banorë të gjitha komuniteteve.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Pasi jam në kontakt të irregullt me komunitetin ata vijnë, për ç'do gjë tek unë, kjo pikë si formulim i tillë më ka prekur shumë. Të gjitha listat për personat që kanë nevojë për lëndë djegëse nga familjet e komuniteteve i ka QPS-ja, ata ju jepin nëse kanë mundësi. Nuk kanë pasur asnjëherë këtë problem. Për pikën e 5 propozoj me nxjerrë një konkluzion.

z.Besnik Seferi; Ka qenë e rrugës ta kemi ZKKK-në prezent këtu. Sa i përket diskutimit për QPS-në, unë besojë që ata e kanë këtë listë për familjet me asistencë sociale, mirëpo nëse ka ndonjë familje që nuk është e përfshirë ne jemi këtu për me i ndihmuar dhe me i dhënë rekomandime si Komitet. Duhet mi qokat në krye Kryesuesit, me bë punë më të mira, pikat e rendit të ditës të bëhen bashkërisht me zyrën e ZKKK-së, dhe neve në bazë të planit të punës të Komitetit. Këtë duhet me pas parasysh për mbledhjen e radhës.

z.Arton Demiri; S'ka asnjë familje me këto probleme, dhe kisha kërkuar nga kryesuesi mos të bjerë më në Komitet, kësi lloj pikash.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Me të vërtetë këto tri pika i kisha hequr krejt prej rendit të ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht Konstatoi se nuk ka ndonjë familje nga komuniteti pakicë që ka pas nevojë e që nuk ka marrë lëndë djegëse. Po ashtu anëtarët e Komitetit për Komunitete u pajtuan se, nëse ka ndonjë rast të tillë që ka nevojë ta bëjnë me dije Qendrën për Punë Sociale, ose Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, në Komunën e Shtimes.**

Pika 6

Diskutim për Organizimin e vizitave të KPK-së në shkollat qe kanë nxënës të komunitetit Ashkali dhe Rom

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Rmadani; Unë mendoj se mundemi me e organizuar një vizitë të tillë.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Edhe unë mendojë që duhet ta realizojmë këtë vizitë.

z.Besnik Seferi; Fillimi që ne duhet me ditë se ku ka nxënës të komunitetit jo shumicë, dhe ti vizitojmë ato shkolla. Më ka përlotur një veprim e një mësuese ku në klasën e saj ka pas fëmijë të komunitetit jo shumicë të cilët nuk kanë pasur mundësi me u furnizuar me disa mjete shkollore, dhe kjo mësuesja vetveti e ka marrë një iniciativë me i furnizuar këta fëmijë me ato mjete shkollore. Diçka çka ka qenë inspiruese për ne të tjerët dhe ajo fëmijëve kur ua ka dhënë ato pajisje ju ka thënë se janë blerë nga prindërit e tyre. Pse jo edhe ne të kërkojmë një far fondi nga bizneset që të dalim në takim e ti njoftojmë për iniciativa të tillë. Mendojë që ka disa biznese që kanë vullnet me na u përgjigj pozitivisht.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Sa i përket vizitës unë jam afër shkollave është mirë me dal në teren me u orientuar dhe me marrë informata. Sa i përket vijueshmërisë ka braktisje nëpër shkolla deri në klasën e nëntë.

z.Besnik Seferi; Drejtori i DKA-së z.Lulzim Sahiti a ka ndonjë statistikë lidhur me këtë problematik që po diskutojmë këtu për vijueshmërinë e nxënësve në shkollë me theks të veçantë braktisja. Qasja duhet me qenë e favorshme, besojë duhet me ju qasë komplet klasës e jo vetëm komunitetit pakicë, qasja është shumë me rendësi. Pse jo edhe OSBE nëse e sheh të arsyeshme me marrë pjesë në këto takime. Duhet ta lëmë takimin në javën e ardhshme.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Më herët ky takim u praktiku të bëhet vetëm me drejtorët e shkollave. UNICEF-i na ka ndihmuar me material gjatë këtyre takimeve.

znj.Shkurte Mustafa; Më e udhës ish kanë me drejtorët e shkollave me u taku se ata janë të informuar a ka braktisje të shkollës nga komuniteti pakicë apo jo.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Të gjitha të dhënat i kanë drejtorët e shkollave.

z.Besnik Seferi; Drejtori duhet të jetë në takim, por të janë edhe të tjerët mësimdhënës, ne shkojmë 10 minuta para takimit. Po që se OSBE-ja do të jetë në këto takime do të na nderojë. Drejtorët dinë me qitë veten shumë mirë ndonjë herë edhe pse gjendja faktike është krejt ndryshe.

zpj.Shkurte Mustafa; Takimi të jetë me gjithë mësimdhënësit.

z.Besnik Seferi; Edhe unë mendojë që të takohemi me gjithë mësimdhënësit.

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Ora mësimore është 40 minuta, pushimi i gjatë është 10 minuta, s'di sa mundemi me krye punë. Më shumë kam dëshirë me bisedu me mësimdhënës se sa me drejtore. Propozoj që vizita do të jetë të premten.

z.Arton Demiri; Pajtohem për të premten.

Pika 6

Te ndryshme

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Hapi diskutimin për këtë pikë.


z.Besnik Seferi; Një sygjerim, kërkojë që pikat e rendit të ditës të janë në pajtim me pikat e Kuvendit. Dhe një vërejtjeje për Kryesuesin e Kuvendit që çdo rekomandim i dal nga KPK-ja të lexohet në Kuvendin e Komunës së Shtimes.

zpj.Rrezart Ramadani; Kemi dërguar vetëm dy rekomandime një herë janë lexuar. Pak më herët diskutuan me Kryesuesin e Kuvendit z.Adnan Ademin që pikat e rendit të ditës së KPK-së të janë në përputhshmëri me pikat e rendit të ditës së Kuvendit të Komunës.

***Komitetit për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, z.Bajram Ilazi që ta marrë më me prioritet çështjen e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete. Përveç të tjerave KPK-ja nga Kryesuesi kërkon që gjatë përpilimit të pikave të rendit të ditës, të bashkëpunojë me ZKKK-në si dhe me Kryesuesin e Kuvendit, dhe t'i harmonizojë pikat me qëllim që ne si Komitet të kemi mundësi të japim Rekomandimet tona për Kuvendin.**

zv.Kryesuesi i Komitetit, z.Muhamed Mehmeti; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, mbledhjen e përfundoi në ora 15:31h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Zv.Kryesuesi i Komitetit
Muhamed Mehmeti